

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## ULLIRI SHQIPTAR ME EKSPERTIZËN ARBËRESHE !

Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC) organizoi vizitën në terren të ekspertit Arbëresh në kultivimin dhe prodhimin e vajit të ullirit Salvatore Armentano. Vizita trajnuese dhe këshilluese e z. Armentano u zhvilluan në kuadër të zbatimit Projekti “Angazhimi i Diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri”, i financuar nga IOM me mbështetjen e AICS. Salvatore Armentano vizitoi dy subjekte shqiptare të prodhimit të vajit të ullirit, Subashi Olive Oil në Marikaj të Tiranës dhe Musa Olive Oil në Skroftinë të Vlorës ku u njoh nga afër plantacionet e pemëve të ullirit, terrenin, teknologjinë e aplikuar në përpunim dhe kushtet e ruajtjes dhe tregtimit.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## HYJNË NË TREG DY PRERJET E REJA TË KARTËMONEDHAVE

Banka e Shqipërisë hedh në treg dy prerjet e reja të kartëmonedhave, ajo 1.000 lekë dhe preja 10.000 mijë lekë që vjen për herë të parë në tregun shqiptar. Prezantimi i kartëmonedhave të reja u bë më 15 qershor nga kreu i Bankës së Shqipërisë Gent Sjeko. “Kartëmonedha më e re, me vlerë 10,000 lekë, prezantohet sot. BSH prezanton sot dy kartëmonedha të reja, prerjet 1 mijë lekë dhe 10 mijë lekë, ku kjo e fundit është një prerje krejtësisht e re në serinë e kartëmonedhave shqiptare. Hedhja në treg për herë të parë përfaqëson në vetvete shkallën e zhvillimit të sistemit elektronik të pagesave, si dhe tregues të tjerë, që lidhen me trajtimin e parasë.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## TRANSFERTAT NDËRKOMBËTARE, SI QARKULLOJNË PARATË E EMIGRANTËVE

Hapja e ekonomisë shqiptare ndaj botës solli që në vitet e parat të tranzicionit rritje eksponenciale të këtij produkti. Jo vetëm tregtia e mallrave, e liberalizuar tërësisht dhe rritja e konsumit të plotësuar nga importet e ka kthyer këtë në një nga produktet më popullore të klientëve të bankave, por edhe hapja e lëvizjes së lirë dhe emigrimi masiv i shqiptarëve në këto tre dekada, kanë sjellë nevojën e shkëmbimeve apo të transfertave midis qytetareve në vend dhe atyre jashtë tij. Ndërkohë që ecuria e pagesave kombëtare nuk u pengua shumë nga pandemia, e kundërta ndodhi me pagesat ndërkombëtare. Sipas Bankës së Shqipërisë, klientët e sektorit bankar shqiptar kryen vitin e kaluar vetëm 982 mijë pagesa ndërkombëtare.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

SUEDIA ZBUT MASAT ANTI-COVID PËR REZIDENTËT SHQIPTARË



PRESTIGJOZJA FRANCEZE “LE FIGARO”: VIZITONI RIVIERËN SHQIPTARE, PERLA E BREGDETIT



KONSULLATAT SHQIPTARE TË MBYLLURA, JA ARSYEJA



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 <sup>.22</sup>	16.62